



Libri i dytë me Skënderbeun në trajtim romantik titullohet "Skanderbeg, La Campagna d'Italia" dhe është shkruar nga Alban Kraja, një shqiptar me banim në Rimini aktiv edhe në komunitetin shqiptar nëpërmjet punës së shoqatës Iliria që drejton prej vitesh dhe angazhimit si president i këshillit të të huajve të provincës së Rimini.

Kraja nuk është i ri

edhe në këto sprova letrare: Para disa vitesh ka botuar "24 imperatori albanesi alla guida di Roma" (titulli i thotë të gjitha), si edhe "Kosovo, la sopravvivenza di un popolo" ku, pavarësisht nga titulli, merret kryesisht me historinë e Shqipërisë nga beteja e Fushë Kosovës deri në pavarësi, duke kaluar nëpër Ali Pashë e Marko Boçar.

Në qëllimet e autorit, libri i tij mbi Skënderbeun "rindërton për herë të parë fushatën e Italisë në 1461 të mbretit të Shqipërisë, Skënderbe". Në paraqitje vihet në dukje se libri përbën një "përmbledhje të paparë faktesh historikë mbi lavdinë e armëtarëve shqiptarë të udhëhequr nga i paepuri Skënderbe, mik i Papa Piut II dhe Ferdinandit të Napolit, por armik i betuar i Anxhoinëve të Francës dhe Muhametit II të Konstantinopojës". Përveç faktit që Skënderbeu nuk ka qenë kurrë mbret, mjafton të lexosh kapitullin e parë të librit në fjalë për të vërejtur se megjithë dëshirën e mirë (që nuk kemi pse ta vemë në dyshim) të mikut tonë Kraja librit në fjalë vështirë se mund të gjejë një vend në raftin e librave mbi historinë apo edhe të sprovave letrare. Për ilustrim, nga kapitulli i parë i librit: "*... la mattina del 28 agosto 1461, un venerdì'. Il mare calmo e i venti propizi hanno richiesto meno di tre giorni per compiere l'attraversata dell'Adriatico. Skanderbeg, re degli albanesi, immobile sul suo cavallo, un arabo purosangue di colore bianco, osserva il suo esercito che, dalle navi ancorate nella rada, continua lo sbarco sulla spiaggia di Trani. Dalla sua postazione, situata su una banchina, nel posto piu' alto della spiaggia, di fronte al mare, non smette un attimo di contemplare il paesaggio. Da li, tutto gli sembra piu' limpido. Il sole brucia e il mare e' di un blu intenso.*" Ata që duan të lexojnë më shumë, mund të porosisin librin duke i shkruar autorit në webmaster@albankraja.co.